



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 29 korrik 2022**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1555\_2022**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtrishme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, që do të vendosen në kulmin e objektit, ngastra kadastrale nr. 2965-0 ZK Shtime me kapacitet të instaluar prej 40 kW në Komunën e Shtimes, e pranuar me datë 25.07.2022 nga aplikuesi personi juridik "Restaurant Mjellma", me adresë: "Shtime" Komuna e Shtimes, Republika e Kosovës,

**në seancën e mbajtur më 29 korrik 2022 nxori këtë:**

**V E N D I M**

**PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM**

- I. **APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit "Restaurant Mjellma", për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, që do të vendosen në kulmin e objektit, ngastra kadastrale nr. 2965-0 ZK Shtime me kapacitet të instaluar prej 40 kW në Komunën e Shtimes.



- II. **OBLIGOHET** – aplikuesi “Restaurant Mjellma”, me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DFE-9069396 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtroj kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi “Restaurant Mjellma”, do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

## **Arsyetim**

- ZRRE, me datë 25.07.2022 nga aplikuesi “Restaurant Mjellma”, ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, që do të vendosen në kulmin e objektit, ngastra kadastrale nr. 2965-0 ZK Shtime me kapacitet të instaluar prej 40 kW në Komunën e Shtimes.
  - Aplikuesi, s’bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 4631 të datës 06.06.2022 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Pëlqimin nr. 06/140 të datës 07.07.2022 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban, Katastër dhe Gjeodezi e Komunës së Shtimes.
  - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit “Restaurant Mjellma”, dhe dëshmive të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike që do të vendosen në kulmin e objektit, ngastra kadastrale nr. 2965-0 ZK Shtime me kapacitet të instaluar prej 40 kW në Komunën e Shtimes, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
  - VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së**

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Izet Rushiti, Anëtar

Selman Hoti, Anëtar

Lutfie Dervishi, Anëtare

Gadi Buçaj, Anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Shtimes,
- KEDS SH.A.,
- KESCO dhe
- Arkivit të ZRRE-së.